VENDIM
Nr. 92, datë 2.6.2020

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "POWERCOMM" SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike"; të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa "e"; 5 pika 1, germa "e" dhe nenit 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15, të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.6.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi licencimin e shoqërisë "PowerComm" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 82, datë 4.5.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë "PowerComm" shpk, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike;

- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median elektronike me *email*-in e datës 4.5.2020 dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria "PowerComm" sh.p.k.;

- Me shkresën nr. 662/2, datë 13.5.2020, i është dërguar shoqërisë shkresa për njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës dhe kërkesa për plotësimin e dokumentacionit të munguar;

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria "PowerComm" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 662/3, datë 20.5.2020, ka paraqitur dokumentacionin e munguar;

- Shoqëria "PowerComm" sh.p.k., është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), në datën 1.3.2018, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" (QKB) me statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

- Aplikimi i Shoqërisë "PowerComm" sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b" "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d", "e") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c", "d") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat "a", "b", "c", "d") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "PowerComm" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti